

I nderuar z. Duriqi,

Për shkak të kostos së lartë në ofrimin e programit deri më tash, dhe vështirësive tjera në kuptim të mbledhjes së borxheve nga klientët, menaxhmentit të Klan Kosovai është dashur të bëjë prioritizim të shpenzimeve. Këto vendime kanë shpjerë në akumulim të përkohshëm të borxhit tatimor.

Sidoqoftë, akumulimi i borxhit tatimor nuk do tëthotë ikje nga obligimet, përkundrazi! KlanKosova ka bërë deklaram tërregullt të të gjitha obligimeve tatimore. Pamundësia e kthimit të borxhit përnjëherë përbën një situatë krejt normale, sidomos për një biznes të ri, siç është rasti me Klan Kosova.

Së fundmi, përtëpërshpejtuar pagesën e borxheve të mbetura, ATK ka bërë marrëveshje me Klan Kosova, ashtu siç bën përditë marrëveshje me subjekte të tjera, për kryerjen e borxhit tatimor.

Menaxhmenti i KlanKosovës shpreson se në të ardhmen e afërt këto rrethana do të ndryshojnë, qoftë për shkak të lehtësimit tatimor (heqja e TVSH-së përmedie) qoftë për shkak të përmirësimit të performancës financiare, rrethana këto të cilat menjëherë do të shpiejnë në normalizim të shpenzimeve dhe dinamikë të shpejtuar të pagesës së borxhit tatimor.

Me respekt,

Menaxhmenti i Klan Kosova